



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:067533
Datë: 17.05.2024
Numri i dokumentit: 05701572

SCC – 09 – 0248

Paditësit :

A Ç J,T, D,M J që të gjithë nga fshati P i Komunës së Prishtinës, e tani Komunës së Graçanicës, V J nga fshati U i Komunës së Fushë Kosovës, dhe O M nga fshati B e P i Komunës së Prishtinës e të cilët me autorizim i përfaqëson, D J nga fshati P i Komunës së Prishtinës e tani Komunës së Graçanicës.

Kundër :

Të paditurat:

1. Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lagjja, "Lakrishtë" Prishtinë.
2. Kombinati Bujqësor Industrial (KBI), "Kosova – Export" - NSh, "Blegtoria – Lavërtaria" me seli në D të E;
3. NEW Co, "Lavërtaria – Blegtoria", Sh.P.K , "Qirambajtje 99 vite" me seli në Prishtinë.

Për : Palët ndërgjyqëse.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me Kolegjin e saj në përbërje me gjykatësin, Agron Hoxhaj, gjykatës kryesues, gjykatësin, Asllan Krasniqi dhe gjykatësen, Diellza Hoxha, anëtarë të kolegjit, jashtë seancës dëgjimore me dt.17.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. NDËRPRITET procesi gjyqësor në këtë çështje juridike kontestimore për shkak të vdekjes së paditësve, A Ç. J nga fshati P i Komunës së Graçanicës dhe V J nga fshati U i Komunës së Fushë Kosovës.

II. Procedura e ndërprerë mund të vazhdohet kur trashëgimtarët ligjor, e marrin përsipër procedurën në këtë çështje juridike kontestimore .

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurëe në këtë çështje juridike kontestimore.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale:

Me dt.01.12.2009, paditësit, A Ç J,T, D,M J që të gjithë nga fshati P i Komunës së Prishtinës, V J nga fshati U i Komunës së Fushë Kosovës, dhe O M nga fshati B e P i Komunës së Prishtinës e të cilët me autorizim i përfaqëson, D J nga fshati P i Komunës së Prishtinës, pranë DhPGjSK-së, kundër të paditurave, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, KBI, "Kosova – Export" - NSh, "Blegtoria – Lavërtaria" me seli në Dobrevë të Epërme dhe NEW Co, "Lavërtaria – Blegtoria", Sh.P.K , "Qirambajtje 99 vite" me seli në Prishtinë, kanë paraqitur dhe atë për shkak të Vërtetimit të pronësisë dhe dorëzimi në posedim i patundshmërisë.

Paditësit, në këtë padi, kanë theksuar se Gjykata Komunaëe në Prishtinë, me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr.1934/66 të dt.25.04.1967, i cili është bërë i plotëfuqishëm me dt.19.06.1968, Ç J e ka shpallur pronar të arës në vendin e quajtur, "B", parcela kadastrale, nr..., Zona Kadastrale (ZK), Preoc në sipërfaqe prej 0,83.82 ha dhe ka urdhëruar të paditurën, KBI, "Kosova – Export" - NSh, "Blegtoria – Lavërtaria" me seli në D të E dhe pronarin e mëparshëm, Ç S , që janë të detyruar që t'ia pranojnë pronësinë dhe t'ia dorëzojnë në posedim arën lëndore, Ç J, e të cilën edhe e kanë bërë në atë mënyrë që pas vdekjes së Ç J edhe më tej, arën lëndore, e mbajnë të paditurit, si trashëgimtarë të të ndjerit, Ç J dhe e cila shihet nga Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, T.nr.81/09 i dt.11.03.2009, se me rastin e regjistrimit të parcelës lëndore në Shërbimin e Kadastrit, e me qëllim të që të kryhej procedura trashëgimore e të ndjerit, Ç J , është vërtetuar se Agjencia Kosovare e Privatizimit, parcelën lëndore e ka vënë në masën e privatizimit dhe se me NEW Co, "Lavërtaria – Blegtoria", Sh.P.K, "Qirambajtje 99 vite" me seli në Prishtinë, kanë arritur Kontratën e privatizimit si dhe për shkak të faktit se parcela lëndore, nuk ka mundur që të jetë objekt i privatizimit sepse më parë, është vërtetuar e drejta e pronësisë për të ndjerin, Ç J .

Tutje, kanë shtuar se meqë Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, në bazë të nenit 4.1 pika (c) të Rregullorës, Nr.2002/13 për themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ka kompetencë për vendosje sipas padisë, paditësit, kanë bërë këtë padi dhe i kanë propozuar që të caktoj shqyrtimin kryesor, t'i administroj provat e cekura më lartë dhe pas vlerësimit të të njëjtave, të merr aktgjykim e me të cilin aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësve, dhe të anulohet Kontrata e privatizimit e cila ka të bëjë me arën në parcelën kadastrale, nr..., "B", Zona Kadastrale, Preoc, vërtetohet e drejta e pronësisë së paditësve,: A Ç J, në 2/10 e saj, T Ç. në 2/10 e saj , D Ç J, M Ç J, në 1/10 e saj V Ç J në 2/10 e saj dhe O Ç M në 2/10 e kësaj padundshmërie si dhe obligohen të paditurs, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtin. Kombinati Bujqësor

Industrial (KBI), "Kosova – Export" - NSh, "Blegtoria – Lavërtaria" me seli në D të E, dhe NEW Co, "Lavërtaria – Blegtoria", Sh.P.K, "Qirambajtje 99 vite" me seli në Prishtinë, që paditësve t'ia pranojnë pronësinë dhe njëkohësisht, t'ia kompensojnë shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në afatin prej 15 ditëve pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Paditësi, kësaj padia, ia ka bashkangjitur provat :

- Kopjen e vërtetuar të aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr.1934/66 të dt.25.04.1967;
- Kopjen e vërtetuar të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, AC.nr.524/68 të dt.19.VI.1968 e me të cilin është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr.1934/66 të dt.25.04.1967;
- Kopjen e vërtetuar të ekstraktit nga libri i evidencës së Gjykatës Komunale në Prishtinë;
- Kopjen e vërtetuar të ekstraktit nga libri Amzë i të vdekurve, D –...për të ndjerin Ç J nga fshati P i Komunës së Graçanicës;
- Kopjen e aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, T.nr.81/09 të dt.11.03.2009 për shpalljen e trashëgimisë si dhe trashëgimtarëve ligjor të tij;
- Kopjen e kërkesës së paditësve për anulimin e Marrëveshjes së privatizimit të drejtuar AKP-së për arën në parcelën kadastrale, nr., "B", Zona Kadastrale, P , dhe
- Kopjen e certifikatës për drejtat e pronës së paluajtshme për NEW Co, "Lavërtaria – Blegtoria", Sh.P.K , "Qirambajtje 99 vite" me seli në Prishtinë;

Me dt.20.04.2010, DhPGjSK-ja, me Urdhrin e saj, SCC- 09 - 0248 të dt.20 Prill 2010, ka urdhëruar paditësin që të bëjë sqarimin lidhur me çështjen se akgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr.1934/66 të dt.25.04.1967, i vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, AC.nr.524/68 të dt.19.VI.1968, a është bërë i ekzekutueshëm, dhe se paditësit apo paraardhësi i tyre, a kanë ndërmarrë hapa të nevojshme për përmbarimin e këtij vendimi apo jo, dërgimit të autorizimit për përfaqësim si dhe për lqthimin e shkresave të kësaj lënde në gjuhën angleze.

Me dt.20 prill 2010, DhPGjSK-ja, me Urdhrin e saj, SCC- 09 - 0248 të dt.20 Prill 2010, ka bërë delegimin e kompetencës.

Me dt.04.05.2010, i autorizuari i paditësve, duke vepruar sipas këtij Urdhri, me Përgjigjjes së tij të dt.04.05.2010, ia ka bashkangjitur provat e më hershme e të përkthyer në gjuhën angleze si dhe e ja bashkangjitur autorizimet e vërtetuara në gjykatë e të dhëna veç e veç për të nga paditësit për përfaqësimin e tyre pranë kësaj gjykate.

Me dt.29 Qershor 2010, DhPGjSK-ja, me aktvendimin e saj, SCC- 09 - 0248 të dt.29 Qershor 2010, padinë e paditësve, e ka refuzuar si të pa pranueshme e më gjerësisht si në këtë aktvendim.

Me dt.04.08.2010, i autorizuari i paditësve, kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë.

Me dt.01 Dhjetor 2010, Kolegji i Ankesave i DHPGJ-së, me aktvendimin e tij, ASC – 10 – 0054 të dt.01.12.20210, e ka pranuar pjesërisht ankesën e palëve paditëse, dhe e ka anuluar aktvendimin e trupit gjykues në lëndën, SCC- 09 - 0248 të dt.29 Qershor 2010 derisa çështjen e ka kthyer në ri gjykim të plotë për të paditurën e tretë, NEW Co, "Lavërtaria – Blegtoria", Sh.P.K , "Qirambajtje 99 vite" me seli në Prishtinë e më gjerësisht ka vendosur si në këtë aktvendim.

Me dt.21 Dhjetor 2010, DhPGjSK-ja, me Urdhrin e saj, SCC- 09 - 0248 të dt.21.12.2010, padinë e paditësve, ia ka dërguar të paditurës për të paraqitur Mbrojtjen në padi mirëpo nuk ka prova se është paraqitur Mbrojtje në padi nga e paditura, AKP-ja.

Me dt.28.02.2011, i autorizuari i paditësve i është drejtuar kësaj gjykate me urgjencën për procedimin e kësaj lënde.

Me dt.21 Mars 2011, DhPGjSK-ja, me Urdhrin e saj, SCC- 09 - 0248 të dt.21.03.2011, të paditurën e parë, AKP-në e ka urdhëruar për sigurimin e adresës së plotë për të paditurën e tretë, NEW Co, "Lavërtaria – Blegtoria", Sh.P.K , "Qirambajtje 99 vite" me seli në Prishtinë.

Me dt. 21 Mars 2011, DhPGjSK-ja, me Urdhrin e saj, SCC- 09 - 0248 të dt.21.03.2011, e ka urdhëruar të autorizuarin e paditësve që të siguroj adresën e të paditurës së tretë, NEW Co, "Lavërtaria – Blegtoria", Sh.P.K , "Qirambajtje 99 vite" me seli në Prishtinë.

Me dt.12.04.2011, i autorizuari i paditësve, i është drejtuar DhPGJSK-së me Përgjigjen e tij, e në të cilën ka sqaruar edhe çështjen e adresës së të paditurës së tretë, NEW Co, "Lavërtaria – Blegtoria", Sh.P.K , "Qirambajtje 99 vite" me seli në Prishtinë si dhe ka sqaruar çështjen se e paditura e parë, AKP-ja, me dt.01.11.2006, përmes privatizimit, ka kryer bartjen e pronësisë nga New Co në N.P."V I I", Sh.P.K dhe e cila gjendet në adresën, Rr,".. në Suharekë e me pronarin, F K.

Me dt.12.04.2011, i autorizuari i paditësve, i është drejtuar DhPGJSK-së me plotësimin e padisë së tij, SCC – 09 – 0249 të dt.31.12.2009 e në të cilën në mes tjerash ka sqaruar se pas që janë kuptuar për NEW Co, "Lavërtaria – Blegtoria", Sh.P.K , "Qirambajtje 99 vite" me seli në Prishtinë, përkatësisht AKP-ja nën të cilën NEW Co, ka qenë nën administrimin direkt të AKP-së, me dt.01.11.2006, përmes privatizimit, ka kryer bartjen e pronësisë nga New Co në N.P.V I I", Sh.P.K dhe e cila gjendet në adresën, Rr,..." në Suharekë e me pronarin, F K, se paditësit kanë konstatuar se në librat e kadastrit, nuk është kryer regjistrimi deri në ditët e sotme por se pronare, ende është NEW Co, "Lavërtaria – Blegtoria", Sh.P.K, "Qirambajtje 99 vite" me seli në Prishtinë si dhe se për shkak të veprimit – sjelljes së NEW Co, "Lavërtaria – Blegtoria", Sh.P.K , "Qirambajtje 99 vite" me seli në Prishtinë përkatësisht AKP-ja nën të cilën NEW Co, ka qenë nën administrimin direkt të AKP-së, me dt.01.11.2006, përmes privatizimit, ka kryer bartjen e pronësisë nga New Co në N.P.V I I", Sh.P.K, paditësit e bëjnë plotësimin

e padisë së tyre dhe i kanë propozuar kësaj gjykate që të nxjerr aktgjykim e me të cilin do të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësve, dhe të anulohet Kontrata e privatizimit e cila ka të bëjë me arën në parcelën kadastrale, nr..., "B", Zona Kadastrale, Preoc, vërtetohet e drejta e pronësisë së paditësve: A Ç J në 2/10 e saj, T Ç J në 2/10 e saj, D Ç J, M Ç J, në 1/10 e saj V Ç J në 2/10 e saj dhe O Ç M në 2/10 e kësaj patundshmërie si dhe obligohen të paditurat, NEW Co, "Lavërtaria – Blegtoria", Sh.P.K, "Qirambajtje 99 vite" me seli në Prishtinë, dhe N.P.V I I", Sh.P.K, që paditësve t'ia pranojnë pronësinë dhe njëkohësisht, t'ia kompensojnë shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në afatin prej 15 ditëve pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm dhe se kësaj parashtrere për plotësimin e padisë, ia kanë bashkangjitur kopjen e aktit të Memorandumit të AKM-së të dt.19 shtator 2006 për valën e -të të shitjes së Kombinati Bujqësor Industrial (KBI), "Kosova – Export" - NSh," Blegtoria – Lavërtaria" etj, dhe kopjen e shkresave të procedurës së shitjes së kësaj NSh-je, dhe kopjen e Marrëveshjes, nr... të dt... të lidhur në mes AKM-së nga shitja e Kombinatit Bujqësor Industrial (KBI), "Kosova – Export", NSh," Blegtoria – Lavërtaria" dhe NEW Co, "Lavërtaria – Blegtoria", Sh.P.K, "Qirambajtje 99 vite" me seli në Prishtinë me N.P.V I I", Sh.P.K, e së bashku me deklaratën e transferit, nr.594/2006 të dt.01.Nëntor 2006, Listën poseduese, Nr., ZK B për patundëshmëritë e evidentuara në emër të PSH, KBI,"Kosova Export", Prishtinë, Listën poseduese, Nr., dhe nr., ZK P për patundëshmëritë e evidentuara në emër të PSH, KBI,"Kosova Export", Prishtinë, Listën poseduese, Nr., ZK M e E për patundëshmëritë e evidentuara në emër të PSH, KBI,"Kosova Export", Prishtinë, Listën poseduese, Nr., ZK S për patundëshmëritë e evidentuara në emër të Prodhimtarisë Bujqësore, M e E, me regjistrat gjegjës, dhe kopjen e Marrëveshjes, nr.595/2006 të dt.01.Nëntor 2006 të lidhur në mes AKM-së nga shitja e Kombinatit Bujqësor Industrial (KBI), "Kosova – Export", NSh," Blegtoria – Lavërtaria" dhe NEW Co, "Lavërtaria – Blegtoria", Sh.P.K, "Qirambajtje 99 vite" me seli në Prishtinë.

Me dt.12.04.2011, e paditira, AKP-ja, i drejtuar kësaj gjykate e duke u përgjigjur në Urdhrin e kësaj gjykate, SCC – 09 – 0248 të dt.21 mars 2011, e duke e sjell – siguruar adresën e N.P.V I I", Sh.P.K dhe e cila gjendet në adresën, Rr,..." në Suharekë.

Me dt.04.10.2013, i autorizuari i paditësve, i është drejtuar DhPGJSK-së me kërkesën e tij për caktimin e shqyrtimit kryesorë dhe vazhdimin e procedurës në lëndën, SCC – 09 – 0248.

Me dt.13.02.2014, i autorizuari i paditësve, i është drejtuar DhPGJSK-së me parashtrësën për ndryshimin dhe plotësimin e padisë, SCC – 09 – 0249 të dt.31.12.2009 e në të cilën në mes tjerash ka theksuar se dy nga paditësit, A Ç J nga fshati P i Komunës së Graçanicës dhe V J nga fshati U i Komunës së Fushë Kosovës dhe trashëgimtarët e tani të ndjerit, Ç J, në ndërkohë kanë vdekur, e duke e ndryshuar padinë në aspektin subjektiv, dhe i ka propozuar kësaj gjykate që të nxjerr aktgjykim e me të cilin do të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësve, dhe vërtetohet e drejta e pronësisë së paditësve: T Ç J në 4/20 e saj, D V J në 2/10 e pjesës së saj, L V J, në 2/10 e pjesës së saj, O Ç M në 4/10 e pjesës së saj, M L J në 2/20 e pjesës së saj, D M J në 2/20 e pjesës së saj, G A J në 1/20

e pjesës së saj, G A S në 1/20 e pjesës së saj, L A L në 1/20 e pjesës së saj, dhe S J në 1/20 e pjesës së kësaj patundëshmërie si dhe obligohen të paditurat, Kombinati Bujqësor Industrial (KBI), "Kosova – Export" - NSh, "Blegtoria – Lavërtaria" me seli në D të E , Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë dhe NEW Co, "Lavërtaria – Blegtoria", Sh.P.K , "Qirambajtje 99 vite" me seli në Prishtinë, që paditësve, t'ua kthejnë patundëshmërinë në fjalë në posedim dhe shfrytëzim të pa penguar, si dhe t'ia pranojnë pronësinë dhe njëkohësisht, t'ia kompensojnë shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në afatin prej 15 ditëve pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm dhe se kësaj parashtrere për plotësimin e padisë, ia kanë bashkangjitur, kopjen e certifikatës së vdekjes, V .. të dt.. për paditësin, V J nga fshati U i Komunës së Fushë Kosovës, dhe certifikatës së vdekjes, V .. të dt.. të A Ç. J nga fshati P i Komunës së Graçanicës, certifikatën e lindjes, L ..1 të dt.. për G A J, certifikatën e lindjes të dt.. për G A S certifikatën e lindjes të dt... për L A L, certifikatën e martesës, M .. të dt... të lidhur në mes A Ç. J nga fshati P i Komunës së Graçanicës dhe S K, kopjen e certifikatën e lindjes, L - . të dt... për D A J kopjen e certifikatën e lindjes, L –..të dt... për L V J dhe kopjet e noterizara të autorizimeve të dhënë nga këta për D J për t'i përfaqësuar pranë DhPGJSK-së.

Arsyetimi ligjor:

Procesi gjyqësor në këtë çështje juridike, duhet të ndërpritet dhe atë për shkak të vdekjes se paditësve, A Ç. J nga fshati P i Komunës së Graçanicës dhe V J nga fshati U i Komunës së Fushë Kosovës.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1. pika 1.1 të Ligjit Nr.06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGSJK), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Procedura gjyqësore pran Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në vazhdim: Dhoma e Posaçme), është e rregulluar me Ligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr. 06/L-086, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr.12/27, Qershor 2019), si ligj i veçantë.

Përveç kësaj, si ligj procedural i përgjithshëm zbatohet Ligji për Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006), me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme. Kjo çështje është definuar me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 76, paragrafi 3, ku është theksuar, se *"Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore"*.

Po ashtu në nenin 277 par.1 pika a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është e përcaktuar se: *''Procesi gjyqësor, ndërpritet : a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale , b) kur përfaqësuesi ligjor i palës vdesë ose shuhet autorizimi i tij për përfaqësim, e pala nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim ''*. Pastaj me nenin 280 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është e përcaktuar se : *''Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a) të këtij ligji do të vazhdohet gjykata i thërret palët''* derisa në nenin 19 të Ligjit Nr. 04/L-118 të dt.13.09.2012 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se : *'' Neni 280 i ligjit bazik, paragrafi 4, togfjalëshi ''me propozimin e palës'' fshihet nga teksti i ligjit ''*.

Kolegji i kësaj gjykate, vlerëson se me gjendjen e tillë të shkresave të lëndës dhe se deri më tani nuk është bërë ndërprerja e procesit gjyqësor dhe atë për shkak të vdekjes së paditësve, se paditësve, A Ç. J nga fshati P i Komunës së Graçanicës dhe V J nga fshati U i Komunës së Fushë Kosovës si dhe se me vdekjen e paditësve, të autorizuarit të deritanishëm, D J nga fshati P i Komunës së Graçanicës, si njëri nga paditësit, i është shuar autorizimi për përfaqësim e është çështje tjetër që trashëgimtarët e paditësve të vdekur, a dëshirojnë që pranë DhGjSK-së, t'a përfaqësojnë vetvetën apo të njëjtët, duhet të angazhojnë ndonjë avokat të licensuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK) pasi që njëri nga paditësit, e këtu edhe i autorizuari e deritanishëm, D J nga fshati P i Komunës së Graçanicës, nuk është avokat dhe se meqë gjykata sipas detyrës zyrtare duhet të kujdeset për zotësinë procedurale të palëve në procedurë siç është në rastin konkret në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata nuk i përjashton mundësinë që trashëgimtarët e tyre ligjor

në cilësi të paditësve, t'a marrin përsipër procedurën e ndërprerë si dhe të njëjtët gjykata i udhëzon se me rastin e propozimit eventual të tyre mbi vazhdimin e procedurës, propozimit për vazhdimin e procedurës së ndërprerë për shkak të vdekjes së paditësve, A Ç. J nga fshati P i Komunës së Graçanicës dhe V J nga fshati U i Komunës së Fushë Kosovës, t'ia bashkangjesin edhe dokumentin gjegjës e me qëllim që t'a dëshmojnë legjitimitetin e tyre aktiv pranë kësaj gjykate në këtë çështje juridike kontestimore, andaj me arsyet e cekura më lartë, Kolegji i kësaj gjykate, edhe e bëri ndërprerjen e procesit gjyqësor në këtë çështje juridike kontestimore.

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62 par.5 të Ligjit nr.06/L-086 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), gjykata vendosi që secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale në këtë çështje juridike kontestimore .

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 9, 76 par.3 të Ligjit, Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) lidhur me nenin 277 par.1 pika a) dhe b) dhe nenit 280 par.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) dhe nenit 19 të Ligjit Nr.04/L-118 të dt.13.09.2012 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK).

**DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR
ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT**

2023:067533, 17.05.2024

Kolegji i shkallës së I-rë

Agron Hoxhaj, Gjykatës kryesues _____

Asllan Krasniqi, gjykatës _____

Diellza Hoxha, gjykatëse, _____

KËSHILLË JURDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimimit të këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).